

**FJALA E KRYETARIT TË PREZENCËS NË PREZANTIMIN
E FORUMIT TË GRUAS NË SINDIKATËN E POLICISË SË SHQIPËRI**
23 nëntor 2011

Zëvendësministrja Zajmi,
Drejtori i Përgjithshëm i Policisë Burgaj,
Zonja dhe zotërinj,
Mirëdita!

Jam shumë i gëzuar që mund të jem me ju sot në këtë aktivitet të organizuar bashkë me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit për promovimin e grave në polici dhe, në veçanti, Forumit të Gruas në Sindikatën e Policisë së Shtetit.

Ky Forum u krijua në qershor të këtij viti, duke sjellë së bashku më shumë se 600 oficerë policie gra.

Ai ka për qëllim të përfaqësojë interesat e oficerëve të policisë, si dhe të përmirësojë pozicionin e grave në forcat e policisë.

Në kuadrin e dimensionit politiko-ushtarak të OSBE-së, Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore të OSBE-së dhe angazhimeve sipas Rezolutës 1325 të Kombeve të Bashkuara, Prezenca e OSBE-së mbështet në gjithë rajonin diskutimet mbi rolin e gruas në polici.

Gjatë viteve të fundit, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri ka mbështetur zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe kundër Dhunës në Familje dhe zbatimin e Ligjit për Barazinë Gjinore në Shoqëri.

Gjithashtu, ne kemi asistuar në forcimin e Këshillit Kombëtar për Barazinë Gjinore, fuqizimin e mekanizmave të qeverisë vendore dhe rritjen e kapaciteteve të stafit që merret me barazinë gjinore në të gjitha ministrinë e linjës.

Ministria e Brendshme nën drejtimin e zëvendësministres Iva Zajmi ka ngritur suksesshëm një *Task Force*, e cila më vonë integroi çështjen gjinore në punën e policisë. Ne mund të themi me sinqeritet se pika fokale e barazisë gjinore në polici është një nga më aktivet dhe ka shërbyer si model për shumë të tjera.

Do të doja të kujtoja se Prezenca e OSBE-së ka ofruar mbështetje edhe për procesin e rekrutimit për të inkurajuar më shumë aplikante gra dhe gra nga minoritetet për t'u bërë pjesë e trajnimit të policisë.

Unë bashkohem me ata që shpresojnë se aktiviteti i sotëm do të ndihmojë që tani e tutje të shohim një Forum aktiv Grash, një forum që do të promovojë kryesisht të drejtat e grave në forcat e policisë dhe që do të kontribuojë në krijimin e kushteve më të mira të punës për gratë police.

E gjitha kjo në pamje të parë mund të duket se është vetëm për gratë. Jo. Është e qartë se nuk është kështu. E gjitha bëhet për ekuilibër, për një shërbim edhe më të mirë policor në të mirë të të gjithë qytetarëve shqiptarë, burra e gra bashkë.

Në fund, do të doja të falënderoja të gjithë të pranishmit për pjesëmarrjen e tyre dhe t'ju uroj një diskutim të frytshëm.

Fund